



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

2489/2
Nr. Prot.

Tiranë, më 04/05/2022

URDHËR

Nr. 178, datë 04/05/2022

**“PËR DHËNIEN E MASËS DISIPLINORE VËREJTJE ME PARALAJMËRIM PËR
HEQJEN E LICENCËS PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT TË NOTERIT DHE GJOBË
NË MASËN 300 000 LEKË PËR NOTERIN [REDACTED]”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 6 dhe 7, të Ligjit Nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të gërmës “a”, “c”, “ç”, të pikës 2, pikës 4, si dhe pikës 5, të nenit 26, të Ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar,

KONSTATOJ:

Me Urdhërin nr. 629, datë 08.11.2021 të Ministrit të Drejtësisë është vendosur fillimi hetimit disiplinor pranë noterit [REDACTED] bazuar në ankesën e shtetases [REDACTED], protokolluar nga institucioni ynë me nr. E-206/2 prot., datë 03.09.2021, ku përmes kësaj ankese znj. [REDACTED], pretendon se noteri z. Bujar Xhaxho ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë testamentare me nr. [REDACTED] rep., nr. [REDACTED] kol., datë 10.06.2021.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar rezulton se, më datë 10.06.2021 është lëshuar dëshmia e trashëgimisë testamentare me nr. [REDACTED] rep., nr. [REDACTED] kol., nga noteri z. [REDACTED], me kërkesë të z. [REDACTED] i cili ka kërkuar lëshimin e kësaj dëshmie për të ndjerën nënën e tij, K.K. E ndjera [REDACTED] e cila ka pasur katër fëmijë konkretisht z. [REDACTED], z. [REDACTED], znj. [REDACTED] dhe znj. [REDACTED], ka lënë testamentin nr. 348; datë 23.05.2010, ku ka caktuar si trashëgimtar testamentar vetëm të birin e saj, [REDACTED], duke përjashtuar në këtë mënyrë fëmijët e tjerë të saj.

Në bazë të pikës 4, të nenit 111, të Ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar, ku sanksionohet se, “Në lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë testamentare, noteri kontrollon nëse disponimet me testament të testatorit janë të vlefshme, sipas parashikimeve të bëra në Kodin Civil.”, noteri përpara lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë testamentare ka detyrim ligjor të verifikojë nëse disponimi i bërë me testament është i vlefshëm ose jo:

Në dëshminë e trashëgimisë testamentare me nr. 811 rep., nr. 278 kol., nga ana e noterit citohet se: “Për sa i përket rezervës ligjore testatori me dokumentet e paraqitura nga kërkuesi nuk rezulton që trashëgimlënësja të ketë trashëgimtar që të përfitojnë nga e drejta e rezervës ligjore sipas nenit 379

te Kodit Civil.” Ky deklarim i noterit rezulton të jetë i pabazuar pasi nga ana e tij nuk është administruar dokumentacioni i plotë për të kryer verifikimet nëse është shkelur rezerva ligjore ose jo.

Konkretisht nga certifikata familjare e të ndjerës [REDAKTUAR], e cila tregon përbërjen familjare të saj deri më datë 21.11.1991, e administruar prej noterit, rezulton që e ndjera të ketë pasur katër fëmijë. Pavarësisht se noteri është njohur me këtë fakt, nga ana e tij rezulton të jetë administruar vetëm certifikata personale për të birin e testatores z. [REDAKTUAR], certifikata e vdekjes për të birin e testatores z. K.K., i cili rezulton të ketë vdekur me gjendje civile beqar, dhe nuk janë administruar certifikata personale apo familjare për dy fëmijët e tjerë të testatores, [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR].

Ligjvënësi me parashikimet që ka bërë në nenin 125 të Ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë” i ndryshuar, i ka dhënë të drejtën noterit për të bërë kërkesë pranë zyrave të gjendjes civile për të administruar çdo dokumentacion i cili është i nevojshëm për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë testamentare apo ligjore, për t’i paraprirë në këtë mënyrë rasteve kur nga personi që kërkohet të çelet trashëgimia nuk paraqet gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të vijuar me lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë.

Ndërkohë nga dokumentacioni paraqitur nga ankuesja, konkretisht nga certifikata familjare, e znj. [REDAKTUAR], lëshuar më datë 31.08.2021, vërejmë se, në kohën e vdekjes së trashëgimlënëses, ankuesja, e cila është përjashtuar nga e ndjera K.K, nëna e saj, me testamentin e lënë pranë noterit z. [REDAKTUAR] ka dy fëmijë të mitur, [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], të cilët përfitojnë nga rezerva ligjore dhe duhet të ishin përfshirë nga noteri si trashëgimtar, në dëshminë e trashëgimisë testamentare të hartuar prej tij.

Neni 379 i Kodit Civil parashikon se: *“Trashëgimlënësi nuk mund të përjashtojë nga trashëgimia ligjore fëmijët e tij të mitur ose trashëgimtarë të tjerë të mitur që trashëgojnë me zëvendësim (neni 361, paragrafi i dytë), si dhe trashëgimtarët e tij të tjerë të paafte për punë në qoftë se thirren në trashëgim, dhe as të cenojë me testament në çdo mënyrë qoftë, pjesën që u takon këtyre trashëgimtarëve në bazë të trashëgimisë ligjore, përveç kur këta janë bërë të padenjë për të trashëguar”,* ndërkohë neni 361 paragrafi 2 parashikon se: *“...Kur një nga fëmijët ka vdekur para trashëgimlënësit, është bërë i padenjë për të trashëguar, ka hequr dorë nga trashëgimi, ose është i përjashtuar nga trashëgimi, në vend të tij hyjnë me zëvendësim fëmijët e tij dhe kur për shkaket e sipërme nuk mund të jenë trashëgimtarë, vijnë në trashëgim të paslindurit e tyre pa kufizim”.*

Ndodhur para një rasti të tillë, kur nëpërmjet disponimit të pasurisë me testament mund të përjashtohen një kategori e caktuar e trashëgimtarëve ligjorë, siç janë fëmijët e mitur të testatorit, trashëgimtarët e tjerë të mitur që trashëgojnë me zëvendësim, të paslindurit e tjerë të mitur pa kufizim, si dhe personat e paafte për punë në ngarkim të trashëgimlënësit, legjislatori ka parashikuar rezervën ligjore si kufizim i vullnetit të testatorit për të mbrojtur interesat e kësaj kategorie të trashëgimtarëve ligjorë.

Në pikën 4 dhe 5 të nenit 113, të Ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar, parashikohet se:

“Noteri në çastin e çeljes së trashëgimisë testamentare, përcakton trashëgimtarët që përfitojnë nga rezerva ligjore dhe i përfshin ata në dëshminë e trashëgimisë, duke arsyetuar në lidhje me përfshirjen si trashëgimtarë përfitues nga rezerva ligjore. Noteri, gjatë hartimit të dëshmisë testamentare, arsyeton në lidhje me ekzistencën e trashëgimtarit/ve që përfiton nga rezerva ligjore dhe përfshin këta trashëgimtarë si trashëgimtarë testamentarë, duke përcaktuar e specifikuar qartë edhe pjesët përkatëse të tyre”.

Referuar kësaj dispozite ligjore, dokumentacionit të administruar prej noterit për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë testamentare dhe dokumentacionit të përcjellë nga ankuesja, konkretisht certifikatës së saj familjare, nga ku rezulton, që ankuesja të ketë dy fëmijë të mitur, të cilët përfitojnë nga rezerva ligjore, duke qenë se e ëma e tyre, pra znj. [REDAKTUAR], është përjashtuar nga trashëgimi, dhe në vend të saj hyjnë me zëvendësim fëmijët e saj, rezulton se noteri z. [REDAKTUAR] në kundërshtim me dispozitat ligjore sipërcituar, nuk ka përfshirë këta trashëgimtarë, në dëshminë e trashëgimisë testamentare me nr. [REDAKTUAR] ep., nr. [REDAKTUAR] kol., datë 10.06.2021 të hartuar prej tij.

Gjithashtu, vlen të theksohet se, lidhur me trajtimin e kësaj çështje, vihen re qëndrimet e ndryshme të mbajtura prej noterit [REDAKTUAR], konkretisht në shkresën me nr. [REDAKTUAR] prot., datë [REDAKTUAR], përmes së cilës noteri z. [REDAKTUAR] i ka kthyer përgjigje kërkesës për informacion që i është drejtuar nga ana jonë, mbi pretendimet e ngritura nga ankuesja, nga ana e tij është deklaruar se, fëmijët e mitur të znj. [REDAKTUAR], nuk përfitojnë nga rezerva ligjore, pasi jetojnë nëna e tyre.

Ndërkohë, diçën kur grupi i inspektimit është paraqitur pranë zyrës së tij noteriale, pasi me Urdhrin nr. [REDAKTUAR], datë [REDAKTUAR] të Ministrit të Drejtësisë është vendosur kryerja e hetimit disiplinor pranë noterit [REDAKTUAR], prej noterit është mbajtur tjetër qëndrim lidhur me këtë ankesë. Konkretisht, nga ana e tij është pranuar se ankuesja ka të drejtë, dhe ka qenë lapsus prej tij, mos përfshirja e dy fëmijëve të mitur në dëshminë e trashëgimisë testamentare, të cilët përfitojnë nga rezerva ligjore. Gjithashtu, prej tij është relatuar se, ka orientuar ankuesen për të zgjidhur këtë problematikë në rrugë gjyqësore, pasi është njohur me ankesën e saj.

Nga ana tjetër, nga grupi inspektimit është konstatuar që procesverbali i çeljes së testamentit dhe dëshmia e trashëgimisë testamentare objekt i këtij hetimi, të jenë regjistruar prej noterit në Regjistrin e Përgjithshëm të Akteve dhe Veprimeve Noteriale dhe në NISA, por nuk rezultojnë të regjistruara në sistemin RNSH.

Ndërkohë, në Vendimin e Këshillit të Ministrave me nr. [REDAKTUAR], datë [REDAKTUAR] "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të shërbimit noterial shqiptar, Regjistri Noterial Shqiptar (RNSH)" dhe Urdhrin nr. [REDAKTUAR], datë [REDAKTUAR] të Ministrit të Drejtësisë "Për përdorimin e Regjistrit Elektronik Noterial Shqiptar (RNSH)", përcaktohet qartë detyrimi për noterët që të përdorin regjistrin elektronik noterial për regjistrimin e të gjitha akteve dhe veprimeve noteriale të kryera, duke filluar nga data 15.03.2013, ku mos hedhja e të dhënave të plota për çdo çështje noteriale, mos procedimi i çështjeve në sistemin elektronik brenda afatit (10 ditor) nga ana e noterëve, ose mos zbatimi i rregullave të përcaktuara në këtë urdhr, përbën shkelje disiplinore në kuptim të Ligjit nr. 110/2018, "Për noterinë", i ndryshuar.

Për sa më sipër, provohet se dëshmia e trashëgimisë testamentare me nr. [REDAKTUAR] ep., nr. [REDAKTUAR] kol., datë 10.06.2021 është hartuar në shkelje të pikës 4, të nenit 111, pikës 4 dhe 5 të nenit 113, të ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë", i ndryshuar, dhe nenit 379 të Kodit Civil, si dhe në shkelje me Vendimin e Këshillit të Ministrave me nr. 304, datë 21.05.2014 dhe Urdhrin nr. 88, datë 4.3.2013 të Ministrit të Drejtësisë "Për përdorimin e Regjistrit Elektronik Noterial Shqiptar (RNSH)",

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 6 dhe 7, të Ligjit Nr. 8678, datë 14.05.2001 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i

ndryshuar, të gërmës "b" dhe "c", të pikës 3, pikën 4 dhe 5 të nenit 26, të Ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë", i ndryshuar,

URD HË R O J:

1. Dhëniën e masës disiplinore "Vërejtje me paralajmërim për heqjen e licencës për ushtrimin e profesionit të noterit dhe gjobë në masën 300 000 lekë" noterit [redacted] anëtar i Degës Vendore të Noterisë Gjirokastrër.
2. Noteri [redacted], të marrë të gjitha masat për përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në legjislacionin në fuqi, që lidhen me ushtrimin e rregullt të veprimtarisë noteriale, sipas parashikimeve të Ligjit 110/2018 "Për noterinë" dhe akteve nënligjore në fuqi.
3. Ky Urdhër t'i njoftohet menjëherë noterit [redacted], Dhomës Kombëtare të Noterisë, si dhe ankueses [redacted].
4. Ndaj këtij urdhri, noterit mund të bëjë ankim në Gjykatën Administrative brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të tij.
5. Ky urdhër, së bashku me të dhënat përkatëse, të regjistrohen në Regjistrin e Noterëve në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, pas kalimit të afatit të ankimit.
6. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë, të marrin masat e nevojshme për zbatimin e këtij Urdhri,

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Ulsi Manja
Ulsi Manja

